



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 15235 Prot

Shkodër, më 20.10.2023

N J O F T I M

Për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër“, i ndryshuar njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak ditën **Enjte, datë 26 Tetor, ora 17:00**, me rend dite si më poshtë:

1. Pr/ Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Shtator 2023”.
2. Pr/ Vendim: “Për emërimin e Drejtorit të Teatrit Migjeni”
3. Pr/ Vendim: “Për miratimin e Rregullores për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane (MNU) Bashkia Shkodër”
4. Pr/Vendim: “Për caktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to, në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër”
5. Pr/Vendim: “Për dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim të një sipërfaqe prej 602 m²(kati parë) dhe 602 m²(kati dytë) objekti “ish Konvikti Safet Spahiu”, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Shkodër, shoqëri aksionare me ofertë publike, me qëllim vazhdimin e ofrimit të shërbimeve rajonale dhe vendore për qytetarët e Qarkut Shkodër”
6. Pr/ Vendim: “Për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në treg të lirë për vitin 2023”
7. Pr/Vendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.

8. Pr/ Vendim: *Për disa ndryshime në VKB nr.27, datë 01.06.2016 "Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër Shkodër", i ndryshuar.*
9. Pr/ Vendim: *"Për shtesë në buxhetin e vitit 2023 e miratuar me VKB Nr.71 datë 27.12.2022 " Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 të Bashkisë Shkodër"*
10. Pr/ Vendim: *"Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të "Agjencia Rrenc" me nr.pasurie 19/2, ZK 3168, indeks hartë K-34-64-(210-B), me sipërfaqe prej 31,165m², nga Ministria e Mbrojtjes tek Bashkia Shkodër".*
11. Pr/ Vendim: *"Për krijimin e komisionit të përkohshëm të Këshillit bashkiak Shkodër,për hartimin e rregullores "Për kriteret dhe procedurën e dhënies së titujve vendorë të nderit dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë*
12. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisione	Dita	Data	Ora
1	Komisioni për çështjet ligjore	E merkure	25.10.2023	11:00
2	Komisioni i buxhetit	E merkure	25.10.2023	12:00
3	Komisioni i rinisë dhe sportit	E merkure	25.10.2023	13:00
4	Komisioni i kulturës	E merkure	25.10.2023	14:00
5	Komisioni i shërbimeve sociale	E merkure	25.10.2023	15:00

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

